   Fitimet e mbartura nga ushtrimet paraardhese te viteve me pare , ne llogarine 108 , te cilat jane per shumen **35.099.213** leke , si dhe shuma e fitimeve te ushtrimit te cituar me lart , gjithsejt ne shumen **48.096.471** leke , te qendrojne te pashperndara ne formen e fitimeve te mbartura, si dhe duke qene se shoqeria ne vite ka investuar kontribute ne natyre dhe vazhdon investimet , te ndermerret operacioni i zmadhimit te kapitalit te nenshkruar me vleresim te ketij kontributi si dhe perfshirjen e ketyre fitimeve ne kete investim dhe zmadhim kapitali .
4. Ne baze neneve 41 dhe 42 , te Ligjit Nr 10.091 date 5.3.2009 " Per auditimin ligjor , organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar " , per Auditimin Ligjor te Pasqyrave Financiare te vitit 2009 , emerohet Ekspert Kontabel i Regjistruar , i shoqerise " KORSEL " Shpk Korce , zoti Bashkim GJATA , i paisur me Licencen Nr. 042 date 10.2.2000 .
5. Për efekt të vlerësimit të kontributit në natyrë, të investuar në shoqëri gjatë

periudhës te dhe aktivitetit te shoqerise , dhe te vertetuar me dokumenta transaksionesh financiare per pagesat ne blerjen e tyre , emërojmë në cilësinë e Ekspertit të Kontributeve, Ekspertin Kontabël të Autorizuar z. Bashkim GJATA, i paisur me Licencen Nr. 042 date 10.02.2000, i cili të paraqesë Raportin e vlerësimit brenda muajit Tetor 2009, para pronarëve të shoqërisë.

6. Ky vendim sipas Ligjeve te cituara me poshte te Depozitohet :

a) Bazuar ne Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 " PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT " si dhe Udhezimin e Ministrit te Financave NR.5, datë 30.01.2006 „Për tatimin mbi te ardhurat", kopje origjinale e ketij vendimi te dorezohet ne sekretarine e Organit Tatimor te varesise se deklarimit deri ne 31.7.2009 , me Nr. protokolli.

b) Bazuar ne Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT „ neni 43 , per depozitimin e Pasqyrave Financiare dhe shenimet shpjeguese te vitit 2008 , te Raportit te Auditimit Ligjor te vitit 2008 , si dhe Kopje te Ketij Vendimi te nenshkruar nga pronari i shoqerise , te skanuara , te depozitohen ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me adresen Elektronike E: mail : bilancqkr@hotmail.com , brenda dates 31.7.2009.

c) Po bazuar ne nenin 43 te Ligjit te cituar me siper , te depozitohet nje kopje e ketij Vendimi duke aplikuar direkt ne sportelet e QKR-se , per emerimin e Ekspertit Kontabel te Regjistruar , te emeruar sipas pikes 5 te ketij Vendimi , me lart . Se bashku te jete kopje e vertetuar njesia me origjinalin e Licences se Ekspertit .

d) Po bazuar ne nenin 43 te Ligjit te cituar me siper , te depozitohet ne QKR, nje kopje e ketij Vendimi , per Emerimin e Ekspertit te Kontributi , Ekspertit Kontabel Bashkim GJATA , i emeruar sipas pikes 6 , se bashku te jete kopje e vertetuar njesia me origjinalin e Licences te Ekspertit Bashkim GJATA.

7. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Dega e Financës.

**ORTAKU I VETËM I SHOQERISE**

**( Maksim FEJZULLA )**

NDËRTIM PASTRIM ImpExp KORSELI Maksim Fejzulla KORÇË ALBANIA

**FIRMA " KORSEL" SH. P. K.**
**BULEVARD " Gjergj Kastrioti"**
**Ish Kryqi Kuq**
**Korce**
**Nr Prot**

**Korce me** 20/ 11 **2009**

**Lenda :** ***Mbi perdorimin e fitimit te bilancit te vitit 2008.***

**DEGES TE TATIM TAKSAVE**

**KORCE**

Po ju dergojme vendimin e ortakut te vetem te firmes firmes per perdorimin e fitimit te vitit 2008.

**PRESIDENTI**
**Maksim Fejzulla**

ImpExp KORSEL Maksim Fejzulla KORÇË ALBANIA

**FIRMA " KORSEL " SH. P K.**
**J64104124 G**
**KORCE**

***VENDIM***

Ortaku u vetem i firmes " Korsel " Sh.P.K. , Korce mbasi shqyrtoi rezultatet e bilancit te aktivitetit financiar te firmes per vitin 2008 , i miratoi ato , miratoi shpenzimet e bera nga firma per investime ne makineri dhe paisje dhe vendosi:

- fitimin e vitit 2008 prej 12.997.258 lek, te mos e shperndaje por ta kaloje ne zmadhim kapitali.

Bashkangjitur vendimin per fillimin e procedurave te zmadhimit te kapitalit

Korce me 17 korrik 2009

**Presidenti I firmes**

**Maksim Fejzulla**

NDERTIM PASTRIM IMPEXS "KORSEL" Maksim Fejzulla KORCE ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 13999

# V E N D I M

## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK§

Sot, me date 29.2 1996 , une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Maksi Fejzullaj i cili kerkon te regjistroje si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk dhe ;

K O N S T A T O V A :

Se kerkuesi kerkon te regjistroje si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk me ortak Maksi Fejzullaj dhe Ioanit Kumiotit, me administrator Maksi Fejzullaj, me seli ne Korce lagjja 14, rruga Partizani, me kapital fillestar 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimit te objekteve civile dhe industriale, turistike, bujqesore, ndertim rrugesh, , ndertim vepra arti te vogla, ndertim ujesjellesish e kanalizime, punime mbrojtje dhe sistemi hidtaulik, rikonstruksione godina civile e ekonomike, veshje fasadash etj. mirembajtje e zhvillim dekori per mjedise urbane.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk me ortak Maksi Fejzullaj dhe Ioanit Kumiotit me administrator Maksi Fejzullaj, me seli ne Korce, lagja 14,rruga Partizani, me kapital fillestar 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vj dhe me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimit te objekteve civile dhe industriale, turistike, bujqesore, ndertim rrugesh, ndertim vepra arti te vogla,ndertim ujesjellesish e kanalizime, punime mbrjtjeje dhe sistemimi hidraulik, rikonstruksione godina civile e ekonomike, veshje fasadash etj. mirembajtje e zhvillim dekori per mjedise urbane . Kunder ketij vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 13999/1

VENDIM

I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 8.10.1997, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesve Maksi Fejzulla dhe Ioanit Kumiotit, te cilet kerkojne depozitimin e vendimit te mbledhjes se Jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve, kontraten e shitblerjes ne skeden perkatese te shoqerise "KORSEL" shpk dhe ;

KONSTATOVA:

Me vendimin nr.13999, date 29.02.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk me ortak Maksi Fejzulla dhe Ioanit Kumiotit, me kapital 100.000 leke, me seli ne Tirane,me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimit e tregtimit te materialeve te ndertimit,te pastrimit te qytetit,tregtim industriale e ushqimore me pakice e shumice importi e eksporti etj.

Me vendimin nr.1 te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve te dates 25.09.1997 u pranua kerkesa e z.Ioanit Kumiotit i cili largohet nga kjo shoqeri dhe ne baze te kontrates se shitblerjes date 04.10.1997 ku transferohen te gjitha kuotat e z. Ioanit Kumiotit prej 80 % ia shet z. Maksi Fejzulla ,i cili zoteron 20 % me blerjen e te cilave tani ai ka 100 % kuota kapital dhe si perfundim ai mbetet ortak dhe administrator i vetem i shoqerise KORSEL shpk.

Gjithashtu ka vendosur te shtoj objektin edhe ne fushen e pastrimeve te mjediseve urbane, tregtim karburante dhe vajra lubrifikante, transport mallra e pasagjeresh si brenda dhe jashte.

Kerkojne te behen ndryshimet perkatese ne Skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit tregtar.

Kerkesa e tyre eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

VENDOSA;

Pranimin per depozitimin e vendimit nr.1 te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve, kontraten e shitblerjes te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" SHPK per largim ortaku,transferim kuotash midis tyre, ku ortak dhe administrator i vetem mbetet z. Maksi Fejzulla,shtesa e objektit edhe ne fushen e pastrimeve te mjediseve urbane, tregtim karburante dhe vajra lubrifikante, transport mallra e pasagjeresh si brenda dhe jashte.
duke u bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen e 2, 4 e 5 me numer rendor 2 si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

Meita Gjini

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 13999/2

VENDIM

I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 8 11.1999, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Maksi Fejzullai, i cili kerkon depozitimin e vendimit te ORTAKUT TE VETEM per shtese objekti, te shoqerise "KORSEL" SHPK dhe;

KONSTATOVA;

Me vendimin nr.13999/1 te gjykates se Rrethit Tirane eshte vendosur te pranohet kerkesa per t'u larguar nje ortak dhe kjo shoqeri mbetet me ortak e administrator te vetem Maksi Fejzulla.

Me vendimin nr.2, date 21.10.1999 te Ortakut te Vetem eshte vendosur shtese objekti edhe ne ;

Ne fushen e punimeve ne siperfaqe te gjelbra, parqe , pyllparqe, mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane, ne fushen e gjelberimit te mjedisit dhe cdo gje lidhur me veprimet funerale.

Kerkesa per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri ne Skeden Perkatese te kesaj shoqerie , eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

VENDOSA ;

Pranimin e kerkeses se kerkuesit Maksi Fejzullai te shoqerise "KORSEL" SHPK per depozitimin e vendimit te ORTAKUT TE VETEM , date 21.10.1999 ku eshte vendosur shtesa e objektit e sipershenuar.Te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen e 2, germa "c" e ne kollonat 4, e 5 me numer rendor 2 si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
Albina Hoxha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 13999/3

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 26. 7 2001, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Maksi Fejzulla, i cili kerkon depozitimin e vendimit te mbledhjes se Jashtezakonshme te Asambles se Ortakeve, kontraten e shitblerjes ne skeden perkatese te shoqerise "KORSEL" shpk dhe ;

K O N S T A T O V A ;

Me vendimin nr.13999/1, date 29.02.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane shoqeria me pergjegjesi te kufizuar KORSEL SHPK eshte me ortak e administrator te vetem Maksim Fejzulla, me seli ne Korce, me kapital themeltar 100.000 leke.

Me vendimin nr. 13999/2, date 27.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte pranuar shtesa e ortakeve Demir Areza dhe Ziso Thodhori.U vendos ndryshimi i emertimit te shoqerise nga KORSEL SHPK ne KORSEL KONDOR SHPK. Pra shoqeria KORSEL KONDOR SHPK behet me tre ortak Ziso Thodhori, Maksi Fejzulla dhe Demir Areza, me administrator Maksi Fejzulla.

Me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te dates 24.06.2001 eshte vendosur largimi i ortakeve Ziso Thodhori dhe Demir Areza duke i shitur kuotat e kapitalit te tyre ortakut qe mbetet ne shoqeri z. Maksi Fejzulla.

Gjithashtu me vendimin e Asamblese u vendos ndryshimi i emertimit te shoqerise nga KORSEL KONDOR ne emertimin e ri KORSEL SHPK.

Me largimin e ortakeve shoqeria KORSEL SHPK mbetet me ortak e administrator te vetem z. Maksi Fejzulla, me seli ne Korce.

Kerkesa e tij per t'u bere ndryshimet perkatese ne Skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit tregtar eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

V E N D O S A ;

**Pranimin per depozitimin e vendimit nr.3 , date 24.06.2001, te Mbledhjes se Jashtezakonshme te ASAMBLESE SE ORTAKEVE, largim ortaku te shoqerise KORSEL KONDOR shpk. Ndryshimi i emertimit te shoqerise nga KORSEL KONDOR shpk ne shoqerine KORSEL SHPK.Me largimin e ortakeve, shoqeria KORSEL SHPK mbetet me ortak e administrator te vetem z. MAKSI FEJZULLA, me seli ne Korce.**

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar per te bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen e 2,4 e 5 , numer rendor 3 si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E
ENKELA BAJO

[stamp: REPUBLIKA E SHQIPERISE – GJYKATA E RRETHIT TIRANE]
[signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr 13999/4

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE
SHQIPERISE
TIRANE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE

# VENDIM
## I GJYQTARIT TË VETËM

Sot në datën 16-06 2003, unë gjyqtare e Gjykatës se Shkallës se parë e Rrethit Tiranë ______ mbasi u njoha me kerkesën e Administratorit të shoqërisë "KORSEL" Shpk Korce Maksim Fejzulla, i cili kerkon që të emërojë Ekspertin kontabël të Autorizuar të shoqërise ne cilesine e Ekspertit të kontributeve , për zmadhimin e kapitalit themeltar me anë të Kontributeve ne natyrë, nga

**Konstatova:**

Me Vendimin e Gjykatës se rrethit Tiranë Nr. 13999 date 29.02.1996 është rregjistruar Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "KORSEL" , me dy ortake themelues, me seli në qytetin Korce, me kapital themeltar 100.000 leke, me objekt veprimtarie " Ndertimi i objekteve civile dhe industriale, turistike, bujqesore, ndertim rrugesh, ndertim vepra arti te vogla, ndertim ujesjellesish e kanalizime, punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik, rikonstruksione godina civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj.mirembajtje e zhvillim dekori per mjediset urbane "

Me Vendim Ansamblesë së ortakeve datë 25.09.1997 , i depozituar ky pranë Gjykates se Rrethit Tirane Nr.13999/1, date 08.10.1997, është pranuar kërkesa për largimin e ortakut Ioanit KUMIOTIT dhe Z.Maksim FEJZULLA mbetet Ortak i vetëm i shoqërisë dhe administratori i Shoqerise dhe zoteron 100 % te kapitalit te shoqerise. Me këte rast është realizuar shtesë në objektin e veprimtarise ne drejtimet " Në fushen e pastrimeve te mjediseve urbane, tregtim karburante dhe vajra lubrifikante , transport mallrash e pasagjeresh si brenda dhe jashte vendit" ; Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane N.13999/2 ,date 27.03.1998 eshte pranuar shtesa e ortakeve Demir Areza dhe Ziso Thodhori gjithashtu eshte nderuar edhe emri i shoqerise nga "KORSEL" ne "KORSEL KONDOR" shpk administrator i shoqerise mbetet Maksim FEJZULLA. Po ashtu me Vendimin e Ortakut të vetem Nr. 2 datë 21.10.1999, i depozituar në Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.13999 / 2 ,date 08.11.1999 është shtuar objekti te shoqerise " Në fushen e punimeve ne siperfaqe te gjelberta , parqe e pyll-parqe, mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane , ne fushen e gjelberimit te mjedisit dhe çdo gje lidhur me sherbimet funerale". Me Vendimin e Asamblese te jashtezakoneshme date 24.06.2001 drejtuar Gjykates se Rrethit Tirane , me Vendimin e Gjykates Nr. 13999/ 3 date 26.07.2001 eshte vendosur largimi i ortakeve te shoqerise Ziso Thodhori dhe Demir Areza duke i shitur kuotat e kapitalit te tyre z.Maksim FEJZULLA i cili mbetet ortaku dhe administratori i vetem i shoqerise. Gjithashtu me kete rast eshte nderuar edhe emri i shoqerise nga"KORSEL KONDOR"shpk ne "KORSEL "shpk me seli ne Korce.

Me Vendimin e Ortakut të vetëm te shoqërisë Nr. 4 datë 31.05.2003 , mbas diskutimit për analizën financiare të shoqërisë si dhe duke u mbështetur mbi investimet që janë bërë nga ortaku i vetem i shoqërisë , është vendosur te fillojnë procedurat ligjore për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me anë të kontributeve në natyre , dhe per këtë në mbështetje te nenit 63 të Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Për shoqëritë tregetare " për vlerësimin e Kontributeve në natyre te shoqërisë , në cilësinë e Ekspertit te Kontributeve është vendosur z.Bashkim Gjata , dhe është ngarkuar edhe Ekspert kontabël i Autorizuar i shoqërisë me mandat 6 vjeçar për kontrollin ligjor të llogarive të shoqerise.

Përsa me sipër , mbështetur në gjykimin e bërë, dokumentacionin e paraqitur për këtë qëllim , kërkesa është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar

**PËR KËTO ARËSYE :**

Në bazë të Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregetare " dhe të Ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 " Për rregjistrin tregetar ",

**V E N D O S A :**

1- Të Depozitohet Vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë "KORSEL" Shpk për emërimin e zotit Bashkim Gjata , Ekspert kontabel i autorizuar në cilësinë e Ekspertit të Kontributeve për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me anë të kontributeve në natyrë

2- Të bëhen rregjistrimet përkatëse në rregjistrin Tregatar në kolonën 2, gërma c, për emërimin e Ekspertit Kontabel të Shoqërisë " KORSEL " Shpk Korçe

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë

**GJYQTARE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË RRETHIT TIRANË**
**Nr. 13999 / 5**

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

## VENDIM
### I GJYQTARIT TË VETËM

Sot në datën 16.06.2003 unë Gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë ..............., mbasi u njoha me kërkesën e kërkuesit Maksim Fejzulla, Administrator i shoqërisë "KORSEL" Shpk Korce, i cili kërkon që të depozitohet Vendimi i Ortakut të vetëm Nr.5. datë 20.06.2003, nga

**Konstatova:**

Me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë Nr. 13999 datë 29.02.1996 është rregjistruar Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " KORSEL ", me ortakëri , me administrator Maksim FEJZULLA, me seli në Korçe, lagja 14, Rruga "Partizani" , me kapital themeltar 100.000 lekë, me objekt veprimtarie " Ne fushen e ndertimit te objekteve civile dhe industriale, turistike, bujqesore, ndertim rrugesh, vepra arti te vogla, ndertim ujesjellesish e kanalizime, punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik ,rikostruksione godina civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj, mirembajtje e zhvillim dekori per mjedise urbane". Me disa vendime radhasi janë bërë ndryshime . Me Vendimin e ortakut te vetem te shoqerise Nr.4 date 31.05.2003 , i depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 13.999 / 4 , për vlerësimin e Kontributeve në natyrë të shoqërisë , në cilësinë e Ekspertit të Kontributeve është vendosur z.Bashkim Gjata.

Me Vendimine Ortakut të vetëm Nr. 5 datë 20.6.2003, eshtë bërë miratimi i rezultatit vjetor të bilançit të shoqerisë per ushtrimin financiar të vitit 2002, si dhe është miratuar zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë për shumën **23.500.000** lekë , nga të cilat për shumën **11.000.000** lekë me derdhje në para duke depozituar tek Noteri me kontratën e dt. 16.6.2003 këtë vlerë, si dhe me vlerën **12.500.000** lekë me vlerësimin e kontributeve në natyre, sipas investimeve të kryera nga ortaku i vetëm në tokë e trualle , ndërtesa , makineri ,paisje e mjete transporti. Me këtë rast janë bërë dhe ndryshime në nenin 5 të Statutit të shoqërisë dhe konkretisht : - " Kapitali themeltar i shoqërisë është **23.600.000** lekë. Ky kapital përbëhet nga të holla dhe nga kontributet në natyrë, dhe me vendim të ortakut të vetëm mund të shtohet . Nuk lejohet që kapitali themeltar i shoqërisë të përfaqësohet nga letra të tregetueshme apo me shërbime.

Miratohet ndarja në pjese e kapitalit themeltar dhe vlera e një pjese nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë . Gjithsejt vlera e pjesëve të Kapitalit themeltar të shoqërisë shkon në masën **23.600** pjesë, të cilat janë 100 % në pronësi të ortakut të vetëm themelues, të ngelur në shoqëri.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë , mund t'i rikthehet ortakut të vetëm ose ortakëve ( na rast shtimi të tyre në shoqëri), vetëm me rastin e likujdimit të shoqërisë , ose në rastin e tërheqjes së kuotës dhe pjesës së tij , duke mbajtur parasysh zhvillimin dhe rezultatin e aktivitetit të shoqërisë ".

**PËR KËTO ARËSYE :**

Në bazë të Ligjit Nr. 7638 datë 10.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " si dhe të Ligjit Nr. 7667 datë 28.1.1993 " Për rregjistrin tregëtar "

**VENDOSA :**

1-Të depozitohet Vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë "KORSEL" Sh.p.k. Korce për zmadhmin e kapitalit themeltar të shoqërisë në shumën **23.500.000** lekë nepermjet kontributit ne natyre dhe derdhjeve në para.

2- Në Statutin e shoqërisë janë bërë këto ndryshime :

Neni 5 i Statutit ndryshuar si vijon :

" Kapitali themeltar i shoqërisë është **23.600.000** lekë . Ky kapital përbëhet nga të holla dhe nga kontributet në natyrë, dhe me vendim të ortakut të vetëm mund të shtohet . Nuk lejohet që kapitali themeltar i shoqërisë të përfaqësohet nga letra të tregëtueshme apo me shërbime.

Miratohet ndarja në pjesë e kapitalit themeltar dhe vlera e një pjese nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë . Gjithsejt vlera e pjesëve të Kapitalit themeltar të shoqërisë shkon në masën **23.600** pjesë, të cilat janë 100 % në pronësi të ortakut të vetëm themelues, të ngelur në shoqëri .

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë , mund t'i rikthehet ortakut të vetëm ose ortakëve ( na rast shtimi të tyre në shoqëri), vetëm me rastin e likujdimit të shoqërisë , ose në rastin e tërheqjes së kuotës dhe pjesës së tij , duke mbajtur parasysh zhvillimin dhe rezultatin e aktivitetit të shoqërisë ".

3-Nga Zyra e Personave Juridikë të bëhen rregjistrimet përkatëse në Rregjistër në kolonën 2 , gërma c, për vlerën e kapitalit themeltar të shoqërisë "KORSEL" Sh.p.k Korce.

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E SHKALLES SE PARE - TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 13999/5

PULLE TAKSE 100 LEKE E SHQIPERISE

GJYKATA E SHKALLES SE PARE - REPUBLIKA E SHQIPERISE TIRANE

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 15.12.2003 une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Maksim Fejzulla kerkon depozitimin e vendimit nr.6, date 09.12.2003 te Ortakut te Vetem te shoqerise KORSEL SHPK dhe;

KONSTATOVA SE :

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar KORSEL SHPK eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 13999, date 23.02.1996, me ortak e administrator te vetem Maksim Fejzulla, me seli ne Korce, me kapital 100.000 leke.

Mbasi disa ndryshimeve me vendimet 13999/1, 13999/2,13999/3, 13999/4 dhe e fundit 13999/5 , date 16.06.2003 kjo shoqeri mbetet po me ortak e administrator te vetem.

Me vendimin e Ortakut te Vetem nr.6, date 09.12.2003, eshte vendosur te shtohet objekti i veprimtarise se shoqerise edhe ne keto fusha ;

4. Operator te prodhimit te energjise elektrike, prodhim i energjise elektrike me venien ne perdorim te hidrocentraleve te rinj dhe me ndertimin e hidrocentraleve te rinj, te kapaciteteve te vegjel e te mesem (nga 0,2-2, 3MWA)
5. Transformim dhe shperndarje te energjise elektrike.
6. Ndertim-montim te impianteve te ndryshme elektrike e rrjet te tensioneve te ulet e te larte.

Afati i veprimtarise se shoqerise do te behet deri ne vitin 2030.

Kerkoj te depozitohen aktet dhe te pasqyrohen prane Skedes se Regjistrit te kesaj shoqerie duke u bere ndryshimet perkatese.

Per sa me siper, nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit 7667 , date 19.11.1992 " Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhet te plotesohen ne te",

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitimin e vendimit nr.6, date 09.12.2003 te Ortakut te Vetem te shoqerise KORSEL SHPK, per shtesen e objektit te sipershenuar .

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregtar, ne kollonen nr.2, germa "c" dhe ne kollonat 4,5 duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE